



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 441/1 Prot.

Tiranë, më 09/03/ 2021

V E N D I M

Nr. 41, Datë 09 / 03 / 2021

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr.28 Regj, datë 24.02.2021, paraqitur nga ankuese R.Sh, kundër znj.G.Xh, Zv/Kryetare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, me pretendimin se është diskriminuar në ushtrimin e të drejtës për punë. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesja ka ushtruar detyrën specialiste IT, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Ka një eksperiencë pune prej 12 vitesh, nga të cilat 7 vite në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat dhe 5 vite në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Gjatë gjithë eksperiencës së saj të punës në administratë në të dy gjykatat ku ka punuar, ankuesja nuk ka patur asnjë vërejtje në lidhje me mbarëvajtjen e punës si specialiste IT nga ana e kryetareve apo gjatë kontrolleve të ushtruara nga audite të ndryshme.

Në datën 23.007.2020, ankuses i është kërkuar asistencë për kompjuterin personal të zv/kryetares së gjykatës, G.Xh, problematikë e cila është rregulluar prej saj. Gjatë këtij momenti është konstatuar se kishte ndodhur një gabim në sistemin ICMIC të gjykatës. Ankuesja ka sqaruar dhe ka kërkuar që të silleshin specialistë dhe të verifikohej se gabimi ishte njerëzor dhe që nuk kishte ndodhur në mënyrë të qëllimshme nga ana e saj. Ky gabim administrativ i krijuar nga zv/kryetarja e gjykatës i'u ngarkua ankuses.

Pas këtij veprimi ankuses i është vendosur në tavolinë një kërkesë për dorëheqje, e cila nuk ishte hartuar prej saj, por nga sekretarja e zv/kryetares. Këtë kërkesë për dorëheqje ankuesja shprehet se e ka nënshkruar në kushtet e presionit dhe dhunës psikologjike, pa vullnetin e saj të lirë dhe me mendimin se të nesërmen do të sqarohej që ishte një gabim njerëzor, i cili mund t'i ndodh secilit që punon në sistemin ICMIC të gjykatave.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Me shkresën nr.90 prot., datë 30.07.2020 ankueses i është komunikuar vendimi i pranimit të dorëheqjes. Ky vendim konsiderohet nga ankuesja si një akt në kundërshtim me vullnetin e saj dhe diskriminues pasi është trajtuar sikur të ishte person i huaj dhe jo një punonjëse e një institucioni që jep drejtësi. Ankuesja ka marrë dëgjime për vendimin vetëm pas disa ditësh pa patur asnjë mundësi që të komunikonte me zv/kryetaren.

Sipas ankueses, e gjithë procedura e dorëheqjes nga puna është e paligjshme dhe në kundërshtim të plotë me nenin 38 të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, pasi vendimi duhet të miratohet dhe të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Gjykatës, ndryshe nga sa ka ndodhur, që vendimi është marrë nga një individ i vetëm, ndërkohë që ligji kërkon vendimarrje kolegjiale.

Ankuesja shpreh se diskriminimi i saj ka vazhduar. Kështu, në datën 21.10.2020, ankuesja i është drejtuar zv/kryetares me një kërkesë për ti vënë në dispozicion kopje të kërkesës së saj të dorëheqjes, por nuk ka marrë përgjigje. Për të marrë kopje të kërkesës së dorëheqjes dhe procesverbalit, ankuesja është detyruar t’i drejtohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Vetëm pas ndërhyrjes së këtij institucioni ankuesja ka mundur të marrë kopje të akteve të kërkuara.

Ankuesja ka aplikuar për një vend pune si mësuese në një shkollë shtetërore, ku ndërmjet dokumentacionit që duhet të dorëzonte për të aplikuar ishte edhe një vlerësim pune nga punëdhënësi dhe fakti që nuk kishte masa disiplinore sipas ligjit. Për të tërhequr këto dokumenta, ankuesja i është drejtuar në fillim kancelares dhe më pas zv/kryetares, fillimisht me email dhe më pas zyrtarisht. Edhe pse ankuesja ka respektuar procedurën dhe është drejtuar me kërkesë (në mënyrë të përsëritur) për të marrë dokumentacionin që i nevojitej, ajo nuk ka marrë asnjë përgjigje, duke pretenduar se kjo sjellje gjithashtu përbën diskriminim kundrejt saj.

Edhe pse kërkesa për vlerësimin e punës dhe vërtetimin që ankuesja nuk kishte masa disiplinore, ishte bërë nga ankuesja, zv/kryetarja i dërgon institucionit ku ajo do të aplikonte për punë, një vlerësim, që sipas ankueses është në kundërshtim me ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 37, 38, 39 dhe 65, të këtij ligji, që kanë të bëjnë me vlerësimin e një punonjësi.

Nga muaji shkurt 2020, kur është vendosur zv/kryetare, G.Xh, e deri në momentin e shkëputjes përfundimtare të marrëdhënieve të punës, ankuesja deklaroi se është ndeshur vazhdimisht me fraza si *“bëje punën se ka plotë të tjerë jashtë që e bëjnë punën tënde”*. Në vazhdimësi ankuesja shpreh se është diskriminuar nga zv/kryetarja G.Xh, në cilësinë e punëdhënësit duke e lënë pa zyrë dhe duke e detyruar ankuesen që detyrat e saj ti kryente në zyrën e kryetares së degës së buxhetit, gjithmonë pasi kjo e fundit të kishte mbaruar punët e veta.

Ankuesja ka drejtuar ankesë për problematikën e saj edhe pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili nëpërmjet shkresës nr.4553/2 prot., datë 02.12.2020, i ka kthyer përgjigje se kërkesa për

shfuqizimin e vendimit nr.90, datë 30.07.2020 si absolutisht të pavlefshëm, nuk ishte objekt i veprimtarisë së këtij institucioni, por ankuesja mund t'i drejtohej organeve gjyqësore.

Në përfundim ankueja kërkon nga Komisioneri pranimin e ankesës dhe konstatimin e sjelljes diskriminuese.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, ndër të tjera në lidhje me shkakun e diskriminimit, të pretenduar nga ana e ankueses. Për këtë arsye, nëpërmjet *email*-it të datës 23.02.2021, ankueses i'u kërkuar të përcaktojë dhe dokumentojë shkakun/shkaqet e diskriminimit dhe të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm për këtë qëllim.

Me *email*-in datë 24.02.2021, ankuesja ka dërguar sqarimet plotësuese në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, duke u shprehur se, shkakun për të cilin pretendon diskriminimin është në kuadër të parashikimit “*çdo shkak tjetër*”, pasi në listë (këtu i referohet listës së shkaqeve të diskriminimit sipas nenit 1 të ligjit nr.10221/2010, të ndryshuar) nuk kishte parashikime për shkak diskriminimi në punë.

Ligji Nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : “*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*” Ndërsa në pikën 2, të po këtij neni, parashikohet se: “*Diskriminim i drejtpërdrejtë*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.”

Referuar parashikimit të nenit 1, marrë së bashku me përkufizimin e diskriminimit, që ligji ka bërë në nenin 3, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje

nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Neni 1, i ligjit, liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është shteruese, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes “për çdo shkak tjetër”. Për të vlerësuar nëse pretendimet e ankueses në lidhje me shkakun e mbrojtur gëzojnë mbrojtje nga parashikimi “*çdo shkak tjetër*”, Komisioneri do të mbajë në konsideratë praktikën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut², në drejtim të interpretimit të shkaqeve/statuseve të tjera sipas nenit 14 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut³.

Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme, objektive ose personale, ose “*status*”, me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri⁴. Gjykata ka theksuar se fjalës “*shkak/status tjetër*” në përgjithësi i është dhënë një kuptim i gjerë.⁵ Gjykata fillimisht vëren që, ndërsa një numër i shembujve konkretë kanë të bëjnë me karakteristikat që mund të thuhet se janë “*personale*” në kuptimin që ato janë karakteristika të lindura ose të lidhura natyrshëm me identitetin ose personalitetin e individit, të tilla si seksi, raca dhe feja, jo të gjitha shkaqet e listuara mund të karakterizohen kështu.

Duke mbajtur në konsideratë standartin e mësipërm, Komisioneri vlerëson se ankuesja nuk ka identifikuar një shkak për trajtimin e padrejtë apo më pak të favorshëm, të pretenduar prej saj. Për diskriminimin e pretenduar ankuesja duhet të identifikonte një shkak, i cili ka shërbyer si bazë për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të pretenduar nga ana e saj.

Paligjshmëria e vendimit nr.90, datë 30.07.2020, mosvendosja në dispozicion e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar apo sjelljet e tjera, si mospajisja me zyrë, të pretenduara dhe të kundërshtuar nga ankuesja, njëkohësisht konsiderohen prej saj, si sjellje diskriminuese. Duke pretenduar se paligjshmëritë e pretenduara dhe të kundërshtuara përbëjnë njëkohësisht edhe diskriminim, ankuesja i është drejtuar Komisionerit me ankesë.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese. Që një sjellje e paligjshme të konsiderohet si diskriminuese, duhet që ankuesi minimalisht të identifikojë dhe të provojë shkakun e pretenduar. Në ankesën objekt shqyrtimi, ankuesja nuk ka identifikuar një shkak për të cilin pretendon se është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe më

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën GJEDNJ.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KEDNJ.

⁴ Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70.

⁵ Shih: *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 70.

pak të favorshme, pra për të cilin pretendon se është diskriminuar nga G.Xh, me funksion zv/kryetare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pretendimet e ankueses nuk mund të konsiderohen pretendime për diskriminim, dhe për rrjedhojë ankesa e paraqitur është e papajtueshme me dispozitat e ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar. Bazuar në nenin 32/1/a, të këtij ligji, Komisioneri ka kompetencë të shqyrtojë vetëm ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

Bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në neni 33, pika 4, germa “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, germa “b” dhe nenin 33 të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr.28 regj., datë 24.02.2021, të paraqitur nga ankuese R.Xh.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Pa shkak
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mospranim